

REPUBLIKA E SHQIPERISE
UJESJELLES KANALIZIME SH.A. SARANDE

ADRESA : Gjashte, Sarande
Tel/Fax ++ 355 852 2 62 64

Specififikimet teknike te procedures “Mirembajte e stacioneve te pompimit te U.K.Sarande”

1. Informacion mbi stacionet e pompimit dhe vendndodhjen e tyre.

Jane gjithsej njembedhjete stacione pompimi per furnizimin me uje, nente nga te cilet ndodhen ne territorin e Bashkise Sarande dhe dy prej tyre, ne territorin e Bashkise Finiq.Eshte gjithashtu edhe nje stacion pompimi per largimin e ujrave te ndotura, I cili ndodhet ne qytetin e Sarandes.Kater prej ketyre stacioneve jane stacione prodhimi uji, qe nxjerrin uje nga puset e shpimit dhe shtate te tjeret jane stacione pompimi mbeshtetes(booster stations), te cilet furnizon me uje, lagje ose zona te caktuara ne territorin qe ne administrojme.Ne keto stacione,ashtu sic eshte pershkruar edhe ne preventiv, jane te instaluara pompa zhytese(ne puse),pompa horizontale dhe verikale(ne stacione mbeshtetes).Pompat jane te llojeve dhe markave te ndryshme si “Grundfos”, “Caprari”, “Aturia”, “Saer”, “Decubital”, “Xrisafi”, per ujin e pijshem dhe “KSB” per ujrat e ndotura.Stacionet e pompimit jane relavisht te rind, stacioni me I vjeter eshte ndertuar ne vitet 2001-2003 dhe stacionet me te rind, dy tre vitet e fundit.Sigurisht, qe gjate kesaj kohe qe kane qene ne funksionim, ne keto stacione jane bere mirembajtje dhe riparime te vazhdueshme te pompave dhe elektromotoreve, disa prej te cilave, jane zevendesuar me aggregate te rind.

2. Kategorite e punimeve

Punimet qe do te kryhen,per mirembajtjen dhe riparimin e elektropompave,jane dy llojesh;

Punime mekanike qe perfshijnë riparimin dhe mirembajtjen e pompave.

Me konkretisht, ne keto punime perfshihen;

zmontimi I pompes nga bazamenti ose nxjerrje nga pusi,transport ne piken e servisit, demontim I vete pompes, riparim ose zevendesim I pjeses se demtuar(kushinete, bosht, permistop, bokoll, distancator, difuzor, elike, etj), montim I pompes, risjelleje ne stacion dhe motim ne bazament ose ne pus.

Pervec ketyre, perfshihen edhe disa punime te tjera te mirembajtjes preventivuese, si gratasime kushinetash ose lubrififikim me vaj, sipas rastit,vendosje litari amianti, shtrengime bulonash, etj.

Punime elektrike, qe perfshijnë riparimin dhe mirembajtjen e elektromotoreve.

Edhe per punimet elektrike, do te ndiqet I njeiti proces pune si per pompat,por per elektromotoret, eshte parashikuar kryesisht avolzhimi(ripeshtjellimi) I tyre dhe, ne disa raste, edhe zevendesimi I pjeseve te tjera te kembimit, si kushineta,permistopa,boshte etj.


3.Preventivi dhe te dhena te tjera teknike

Ne preventivin hartuar per realizimin e kesaj procedure prokurimi percaktohen; marka dhe tipi I pompes dhe I elektromotorit,numrat e pompave dhe elektromotoreve.

Ne preventiv jane te perfshira edhe punimet shtese si,demontim dhe montim I pajisjes(nxjerrje dhe rifutje ne pus),transport deri ne piken e servisit dhe risjellje,per cdo sherbim qe do te kryhet dhe do t'I kete te nevojshme keto punime.

Ne preventiv jane paraqitur punimet dhe pjeset e kembimit, qe mund te nevojiten per nje elektropompe ,te cdo marke ose te cdo stacioni pompimi, por, Autoriteti Kontraktor, ka te drejte, qe te riparoje me shume se nje pompe te se njejtes marke,mjafon qe ky punim te kryhet ne baze se vlerse se ofertuar per riparimin e kesaj pompe dhe vlera totale e punimeve ne asnje rast te mos e kaloje vleren totale te kontrates.

Lubrifikantet qe do te perdoren per pompat zhytese te largimit te ujrave te ndotura do te jene vajra jo tokiske tip Mercury No;7174,Merkur White oil Pharma 40 ose ekuivalent SAE 10W, SAE 20W dhe graso ESSO UNIRES N3, FAG ARCANOL L40,TEXACO HYTEC EP3/DEA Pragon ose ekuivalente me to.



4.Sqarime dhe detyrime per operatorin ekonomik

Operatori ekonomik ose ofertuesi,kur te paraqese oferten e tij,duhet te kete parasysh se, cdo ze punimesh ,qe do te kryhet,ne rastet kur do te kerkoste zevendesim te pjeseve te demtuara,eshte furnizim dhe vendosje e kesaj pjese,prandaj zeri I **punetorise(hak pune)**,nuk do te paraqitet me vete ne preventiv.

Nga ana tjeter, operatoret ekonomike, qe do te marrin pjese ne konkurim, duhet t'a kene te qarte se,meqenese kemi te bezme me nje procedure konkurimi, qe do t'I paraprije nje **marreveshjeje kuader**,Autoriteti Kontraktor nuk eshte I detyruar te kryeje cdo punim sipas zerave te preventivit,dhe te paguaje te gjithe vleren limit te kontrates. Ne cdo rast, autoriteti kontraktor do te paguaje operatorin ekonomik, per ato pune,sherbime,riparime, qe do te ndodhin faktikisht.

Operatori ekonomik,eshte I detyruar te kryeje me cilesi te larte dhe ne kohe, cdo punim, qe do t'I kerkoste autoriteti kontraktor,sipas zerave te punimeve ne preventiv,brenda vleres limit per cdo ze(njesi),qe operatori ekonomik, ka ofertuar.

Per cdo punim(riparim) te kryer, operatori ekonomik duhet te leshoje nje certificate garancie, me afat jo me te vogel se nje vit, nga data e dorezimit perfundimtar te sherbimit. Cdo defekt qe do te ndodhet ne pajisjen e riparuar, brenda periudhes se garancise, do te riparohet nga operatori ekonomik(me vone kontraktuesi), me shpenzimet e tij.

Operatori ekonomik, duhet te marre masa qe, cdo pjese kembimi, te percaktuar ne preventiv, ne baze te markes,tipit,apo numrit te pajisjes, te jete ne gjendje t'a siguroje dhe sa me shpejt.Mospasja apo mossigurimi ne kohe I kesaj apo ketyre pjeseve te kembimit, ne qofte se do te sjelle vonesa te pajustifikueshme per riparimin e agregatit dhe si rrjedhim edhe te punes normale te staciont te pompimit, do te behet shkak per zgjidhjen e njeanshme te kontrates.

5.Praktika e punimeve

Operatori ekonomik(kontraktuesi) , do te njoftohet zyrtarisht(bejne perjashtim rastet, qe do te konsiderohen emergjente nga Autoriteti Kontraktor) per defektin dhe pa humbur kohe do te paraqitet me specialistet e tij prane stacionit qe do te kete problem.Pas konstatimit, konfirmimit te defektit, nga te dyja palet, pra specialistet e tij dhe tanet, agregati I demtuar do t'I dorezohet operatorit, me ane te nje akti dorezimi ose flete daljeje provizore.

Operatori ekonomik(me vone kontraktuesi), pasi t'a verifikoje me ne thellesi defektin, duke e zmontuar aggregatin ne piken e tij te servisit,do t'I dergoje Autoritetit Kontraktor, nje raport te hollesishem teknik, ku te pershkruhen ne menyre te detajuar defektet e ndodhura dhe sipas tij, aresyen perse kane ndodhur dhe se bashku me te nje preventive-oferte, per punimet dhe pjeset e kembimit te nevojshme per riparim, duke iu permabjatur rigorozisht, kushteve te parashkruara ne kontrate.

Pasi Autoriteti Kontraktor, t'a kete miratuar kete sherbit, operatori do te vazhdoje pune, per riparimin e defektit, sipas afateve te paracaktuara.Pas perfundimit te riparimit,operatori do te krye testimet e nevojshme, te cilet , do t'ia paraqese edhe Autoritetit Kontraktor dhe do t'a montoje pajisjen ne stacion.Agregati ose pajisja do te punoje ne periudhe prove per 72 ore, dhe pas kesaj, do te merret ne dorezim, me nje garanci, te pakten nje vjecare.

Per te gjitha keto hapa, qe pershkruam me lart, autoriteti kontraktor dhe operatori ekonomik(kontraktuesi) do te plotesojne nje dokumentacion,I cili do te pershkruhet me hollesisht ne kontrate.

Ne rastet qe, do te konsiderohen emergjente nga Autoriteti Kontraktor,prioritet do t'I jepet zgjidhjes sa me shpejt te problemit, perkunder dokumentimit rigoroz te proceseve qe pershkruam me siper.Por, sidoqoftë,edhe ne keto raste, per aq sa eshte e mundur, do te mbahet nje dokumentacion, I cili te deshmoje punen e kryer.

6.Afati i punimeve

Afati I kesaj marreveshjeje , do te jete **dy vjecar**,pra, per dy vjet, nga data e lidhjes se kontrates, operatori ekonomik fitues, do te jete perjegjes per mirembajtjen e pajisjes elektromotor pompe, sipas kushteve te parashkruara ne preventiv dhe specifikime teknike.Ndersa afati I kontrataave qe do te lidhen, bazuar ne kete marreveshje, do te vendoset ne varesi te punimeve te nevojshme,per riparimin e defektit(eve) per cdo rast, ne varesi te rendesise teknologjike qe ka ky stacion pompimi,pompa e te cilit

eshte defektuar, apo edhe ne varesi te periudhes kohore ne te cilin ndodh defekti(perben emergjence apo jo).

Pergatiti

Inxh. Altin Maci

Miratoi

Administratori

Inxh. Sheme Lulo

